



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrasnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Kosovska Akademia za Javnu
Bezbednost/Kosovo Academy for Public Safety

Fakulteti i Sigurisë Publike / Fakultet Javne Bezbednosti / Faculty of Public Safety

TREGUESIT KRYESOR TË PERFORMANCËS

Dokumentet e poshtë ngjitura janë një dëshmi e treguesve kryesor të performancës të cilët ofrohen dhe mirëmbahen në AKSP gjegjësisht në FSP.

Dokumenti përbëhet nga faktorët e jashtëm dhe të brendshëm të cilët nxisin motoriken e ndryshimeve gjithnjë duke u nisur nga strategjitë zhvillimore në AKSP/FSP si dhe objektivate kyçe në zhvillimin dhe përmirësimin e performancës së përgjithshme në fushën e arsimit të lartë në AKSP/FSP.

PËRMBAJTJA

TREGUESIT KRYESOR TË PERFORMANCËS.....	4
Cilësia mësimore	6
Studenti në qendër	10
Hulumtimi shkencor	12
Bashkëpunimi.....	15
Kapacitetet infrastrukturore dhe financiare	17

TREGUESIT KRYESOR TË PERFORMANCËS

Arsimi i lartë në AKSP u themelua me ndihmën e Komisionit Evropian u jetësua Projekti i Binjakëzimit me titull: “Përmirësimi i arsimit në sektorët e sigurisë dhe rendit publik” implementuar gjatë periudhës 2012 – 2014 nga Finlanda dhe Estonia. Më pas u themelua Fakulteti i Sigurisë Publike - Arsimi i Lartë me standardet evropiane, diçka që më parë nuk kishte ekzistuar jo vetëm në Akademi, por as në Kosovë dhe në Regjion.

Në projekt kontribuan më se 170 zyrtarëve nga Institucionet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. përfshirë 26 Ekspertëve nga Finlanda dhe Estonia. Gjatë periudhës 2012 – 2014, kompletohet korniza ligjore; hartohet “Strategjia Zhvillimore e Akademisë dhe Plani i Veprimit”, për vitet 2014 – 2018, rekrutohet stafi i përhershëm akademik në (mars 2014).

Në vitin 2014, arrihet vendimi i akreditimit të programit studimor katër vjeçar (240 ECTS) për periudhën trevjeçare, 01 tetor 2014-31 Shtator 2017. Viti i parë akademik 2014/2015 në AKSP, i cili filloj me 15 tetor 2014, u regjistruan 69 studentë nga ISP-të, AKSP.

AKSP ka vazhduar rrugëtimin e saj dhe matjet e performancës kanë qenë kurorëzim i njohjeve edhe ndërkombëtare.

AKSP ka hartuar dhe miratuar Strategjinë Zhvillimore dhe planin e veprimit 2023-2026. Misioni dhe vizioni i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike janë formuluar nëpërmjet rolit të saj dhe janë në pajtim me pritshmëritë e të gjitha grupeve të interesit,

Misioni i Akademisë është të ofroj trajnim, arsimim dhe hulumtim me cilësi të lartë në fushën e sigurisë publike për të ndihmuar në ofrimin e ambientit të sigurtë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Akademia përmes ofrimit të trajnimeve dhe arsimimit me cilësi dhe standarde të ekselencës do të jetë faktor kyç në ngritjen e kapaciteteve të zbatuesve të ligjit konform ndryshimeve dhe sfidave me të cilat përballën

Vlerat themelore të AKSP-së përshkruajnë bindjet të cilat janë ndarë me të gjitha palët e interesit. AKSP-ja ka përcaktuar këto vlera themelore:

ndershmëria, transparenca, përgjegjësia, etika profesionale & diversiteti.

Secila prej funksioneve është i paraparë dhe rregulluar me aktet e nxjerra nga autoritetet relevante, përkatësisht me rregulloret e nxjerra nga Qeveria, Drejtori i Përgjithshëm, si dhe nga Këshilli i FSP-së.

Akademia e Kosovës për Siguri Publike vazhdon të jetë qendra e ekselencës dhe si e tillë është esenciale për sigurinë e përgjithshme të sigurisë në vend dhe rajon. AKSP vazhdon të jetë një shembull i cili ndjeket nga akademitë simotra të rajonit gjithnjë duke iu gëzuar të arriturve si në sferën vendore ashtu edhe në atë ndërkombëtare. AKSP është një projekt i bashkërenditur në formatin vendor dhe atij ndërkombëtar duke zgjeruar fushën e parametrave dhe duke procesuar të dhëna të cilat në bashkëdyzim, ofrojnë mekanizma krahasues të lehtësuara për të vazhduar para në hap me kërkesat dhe nevojat për të mbetur një shembull që duhet ndjekur nga të tjerët.

Këta tregues janë ofruar në koordinim të plotë me Institucionet e Sigurisë Publike dhe planet qeveritare të cilat fushën e sigurisë publike e shohin si objektivin strategjik kyç në kohën aktuale për një të ardhme më të sigurtë. Dokumenti i treguesve të performancës i është paraqitur menaxhmentit të AKSP dhe si i tillë gëzon mbështetjen e plotë si dokument përcjellës i doracakut të cilësisë së AKSP, ku pas ligjit të AKSP është dokumenti më i lartë në Institucion.

Dokumenti është i ndarë në pesë seksione të gjera siç identifikohet më poshtë, duke përshkruar secilën nga pikat në listën më poshtë:

- 1. Cilësia mësimore;**
- 2. Studenti në qendër;**
- 3. Hulumtimi shkencor;**
- 4. Bashkëpunimi;**
- 5. Kapacitetet infrastrukturore dhe financiare.**

Cilësia mësimore

Cilësia e studimeve dhe profesionalizmi i stafit tonë akademik monitorohet dhe vlerësohet në mënyrë të vazhdueshme nga organet përgjegjëse brenda Akademisë në mënyrë që komunitetit t'i shërbejmë kuadro me etikë, profesionalizëm dhe kompetencë.

Misioni kryesor i menaxhimit të cilësisë është përmirësimi i vazhdueshëm i punës së njësisë akademike. Ekzistojnë mekanizmat për sigurimin dhe zhvillimin e cilësisë në AKSP/FSP-së të cilat janë si në vijim:

- Divizioni për Sigurimin e Cilësisë;
- Komisioni për Sigurimin e Cilësisë;
- Koordinator i programit Bachelor;

Për funksionimin efektiv të sistemit të cilësisë ne kemi krijuar edhe instrumentet përsigurim te cilësisë që janë pjesë e divizionit për sigurim të cilësisë.

Procedurat e anketimit janë pyetësorët të ndryshëm të cilët janë të ofurara në formatin fizik dhe atë elektronik përmes sistemit “moodle”, dhe ofrohen për **stafin akademik dhe studentët** si në vijim:

- (Pyetësori me përgjigje të studentëve për vlerësimin e mjedisit arsimor dhe studimor - Ky pyetësor ka për qëllim të mbledh pikëpamjet për procesin e mësimdhënies, përmbajtjen e lëndës, metodologjinë e aplikuar, strategjitë e mësimdhënies, vlerësimin për standardet e arritura, si dhe të vlerësojë mësimdhënësit për programin dhe përvojën e tyre në fushën e sigurisë publike Ky plotësohet një herë gjatë semestrit veror ose dimëror);
- (Pyetësori me përgjigje të studentëve për vlerësimin e njësisë studimore - Ky pyetësor ka për qëllim të bëjë vlerësimin e njësisë studimore);
- (Pyetësori i kënaqshmërisë së personelit – Ky vlerësim bëhet për tërë personelin në kuadër të AKSP-së, duke përfshirë fushat e përgjithshme,);
- (Pyetësori për mobilitetin studentor - Ky pyetësor bazohet në anketimin e studentëve për fushën e mobilitetit studentor , përvojat e fituara, puna dhe angazhimi i tij në aspektin teorik dhe praktik të shkëmbimit të përvojave
- (Pyetësori i vlerësimit të përgjithshëm të konferencës- Kjo formë përdoret vetëm për

vëzhgimin e përgjithshëm të konferencës duke ofruar përmirësim të vazhdueshëm të përvojave dhe temave të interesit të përgjithshëm në fushën e sigurisë publike);

- (Pyetësi për vlerësimin e internshipit-periudhës praktike – Kjo formë plotësohet një herë në vit për fazën e internshipit dhe ofron të dhëna mbi performancën e mentorëve, koordinatorit të internshipit dhe stafit akademik në proces të arsimit dhe programit studimor);

Formulari i vlerësimit është pjesë përmbyllëse e dokumenteve si në vijim:

- *Raporti ditor i studentit gjatë periudhës praktike*
- *Forma e vetëvlerësimit të studentit*
- *Raporti i studentit*
- *Raporti javor i mentorit gjatë periudhës praktike*
- *Forma e vlerësimit përfundimtar të studentit nga ana e mentorit*
- *Punimin e studentit*
- *Raportin e Vetëvlerësimit*
- *Prezantimin e studentit para komisioni*

(sipas manualit të internshipit për programin Bachelor-siguria publike)

- (Pyetësi i vlerësimit të pjesëmarrjes në projektet e organizuara nga AKSP –jashtë vendit- Kjo formë plotësohet sipas nevojës dhe pas përfundimit të projekteve të ofruara nga AKSP në bashkëpunim me spektrin vendor dhe ndërkombëtar duke prezantuar të gjitha përvojat në përmirësimin e vazhdueshëm në fushën e projekteve dhe mundësive të ofruara si për stafin akademik ashtu edhe për student);

Plani i veprimit-cilësia mësimore

Instrumenti / Pyetësi	Kush plotëson	Kur plotësohet	Çfarë mat?	KPI / Tregues kryesor	Objekti vjetor	Metoda e përlllogaritjes
Pyetësi për mjedisin arsimor dhe studimor	Studentët	Një herë gjatë semestrit veror/dimëror	Cilësia e mësimdhënies, përmbajtja e lëndës, standardet e arritura	Nota mesatare e vlerësimit të mësimdhënësve	$\geq 4.0 / 5$	Shuma e pikëve të studentëve / Numri i studentëve
Pyetësi për vlerësimin e njësisë studimore	Studentët	Një herë në semestër/vit	Funksionimi i njësisë akademike	Përqindja e studentëve të kënaqur	$\geq 80\%$	Numri i studentëve që shprehen të kënaqur / Numri total $\times 100$
Pyetësi i kënaqshmërisë së personelit	Stafi i AKSP-së	Një herë në vit	Përceptimi mbi organizimin dhe mbështetjen	Nota mesatare e kënaqësisë	$\geq 4.0 / 5$	Shuma e pikëve të stafit / Numri total i stafit
Pyetësi për mobilitetin studentor	Studentët pjesëmarrës	Pas përfundimit të mobilitetit	Përvoja teorike dhe praktike	Përqindja e studentëve që raportojnë përvojë pozitive	$\geq 85\%$	Numri i studentëve të kënaqur / Numri total $\times 100$
Pyetësi i vlerësimit të konferencave	Pjesëmarrësit	Pas përfundimit të konferencës	Cilësia e organizimit dhe përvoja	Nota mesatare e konferencës	$\geq 4.0 / 5$	Shuma e pikëve / Numri total i pjesëmarrësve
Pyetësi për periudhën e internship-it	Studentët	Një herë në vit	Performanca e mentorëve dhe programit	Përqindja e mentorëve të vlerësuar pozitivisht	$\geq 90\%$	Numri i mentorëve me vlerësim pozitiv / Numri total $\times 100$
Pyetësi për pjesëmarrjen në projekte jashtë vendit	Studentët / Stafi	Pas përfundimit të projektit	Përvojat dhe angazhimi	Përqindja e pjesëmarrësve të kënaqur	$\geq 85\%$	Numri i pjesëmarrësve të kënaqur / Numri total $\times 100$
Raporti ditor i studentit gjatë praktikës	Studentët	Çdo ditë	Aktivitetet e përditshme	Numri i aktiviteteve të realizuara sipas planit	100% realizim	Numri i aktiviteteve të përfunduara / Numri i aktiviteteve të planifikuara $\times 100$
Vetëvlerësimi i studentit	Studentët	Një herë gjatë praktikës	Vetëvlerësimi i performancës	Nota mesatare e vetëvlerësimit	$\geq 4.0 / 5$	Shuma e pikëve të studentëve / Numri total

Raporti javor i mentorit	Mentori	Një herë në javë	Vlerësimi i progresit të studentit	Përqindja e aktiviteteve të realizuara sipas planit	$\geq 90\%$	Numri i aktiviteteve të realizuara / Numri total $\times 100$
Vlerësimi përfundimtar i studentit nga mentori	Mentori	Pas përfundimit të praktikës	Performanca totale e studentit	Nota përfundimtare	$\geq 8 / 10$	Mesatarja e notave nga raportet dhe prezentimet
Punimi i studentit	Studentët	Pas përfundimit të praktikës	Aftësitë e fituara dhe përmbajtja akademike	Nota e punimit	$\geq 8 / 10$	Vlerësimi i komisionit
Prezantimi i studentit para komisionit	Studentët	Pas përfundimit të praktikës	Aftësia për prezantim dhe reflektim	Nota e prezantimit	$\geq 8 / 10$	Vlerësimi i komisionit

Studenti në qendër

Studenti mbetet, dhe është qendra e vëmendjes së AKSP/FSP, andaj përshtatshmëria është bazuar në akomodimin e studentit në nxitjen dhe praktikimin e programit aktual nga ai teorik në atë praktik gjithnjë duke modifikuar nevojat e paraqitura nga hisedarët publik të sigurisë dhe të konkretizuara në AKSP.

Më poshtë do t'i elaborojmë treguesit e performancës veç e veç që lidhen me mësimdhënien dhe mësimnxënien me studentin në qendër:

Performanca akademike e studentëve-ky tregues i performancës e mat performancën e studentëve përmes notës mesatare të akumuluar dhe bazuar në specifikat sipas programit të studimit. Ky tregues i performancës tregon notën mesatare të studentëve ndër vite.

Braktisja e studimeve - ky tregues paraqet përqindjen e numrit të studentëve të cilët i braktisin studimet në AKSP (për arsye akademike apo jo-akademike) para kompletimit të programit të studimeve me numrin total të studentëve të regjistruar për semestër.

Mobiliteti në Akademi - llojet e mobilitetit janë si në vijim:

- Mobiliteti i realizuar nga studentët e FSP-së në ndonjë institucion vendor ose ndërkombëtar të arsimit;
- Mobiliteti i realizuar nga studentët vizitorë në FSP;

Realizimi i mobilitetit të studentëve arrihet përmes:

- Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërinstitucional me institucionin përkatës;
- Marrëveshjes së bashkëpunimit përmes programit të shkëmbimit ERASMUS+;
- Me formë individuale me institucione me të cilat AKSP nuk ka marrëveshje ndër institucionale të bashkëpunimit;
- Mënyra e llogaritjes së kredive (ECTS) bëhet në përputhje me udhëzuesin evropian për llogaritje të ECTS-ve (ECTS Users Guide) dhe rregulloret përkatëse të programeve studimore të AKSP-së.

Procedura e mobilitetit për studentët e FSP-së

- Shpallja e njoftimit për mobilitet / trajnim / studime / vizitë studimore
- Komisioni për mobilitet / trajnim / vizitë studimore
- E drejta e ankesës
- Obligimet e studentëve të FSP-së
- Të drejtat e studentit të FSP-së
- Njohja e mobilitetit

Procedura e mobilitetit për studentët vizitorë

- Procedura e aplikimit për mobilitet për studentët vizitorë
- Afatet kohore
- Shqyrtimi i aplikacionit të studentit vizitor në FSP
- Të drejtat e studentit vizitor
- Obligimet e studentëve vizitorë
- Mbikëqyrja e procesit

I gjithë procesi i mobilitetit të studentëve mbikëqyret nga DMJ dhe në koordinim me FSP-në.

Të diplomuarit tanë - përmes këtij treguesi të performancës matim numrin e studentëve që kanë kryer studimet Bachelor tek ne. Studentët tanë sipas rregullores për arsimin e lartë, janë të një sistemi të mbyllur, andaj të gjithë janë të punësuar.

Mësimdhënia - norma mësimore e një profesori është numri ekuivalent i studentëve me ngarkesë të plotë mësimore për profesor në aspektin teori dhe praktikë, këshillim dhe mentorim.

Raporti teori-praktikë - përmes këtij treguesi të performancës ne e paraqesim lidhshmërinë dhe raportin në mes të teorisë dhe praktikës të lëndëve mësimore dhe moduleve. Përmes këtij treguesi të performancës ne e paraqesim lidhshmërinë dhe raportin në mes të teorisë dhe praktikës të lëndëve mësimore në nivel. Programi në vetë ka 1/8 pjesë praktike dhe është obligative në kuadër të programit e cila ndërlidhet në kuadër të hartëzimit të rezultateve mësimore me aspektin teorik duke kompletuar dhe përmbushur misionin programor e cila kurorëzohet me kompetencës profesionale. Pjesa e praktikës – internshipit ofron një eksperiencë dhe shkëmbim unik të

përvojave e cila tashmë po merret si shembull edhe nga vendet e rajonit.

Plani i veprimit -studenti në qendër

Hulumtimi shkencor

Akademia e Kosovës për Siguri Publike ka mandat ligjor për të kryer hulumtime dhe zhvillime në fushën e sigurisë publike. Stafi akademik i AKSP-FSP realizon punët kërkimore të cilat janë nxjerr nga praktikat të cilat prekin fushat e studimit të sigurisë publike duke e pasuruar elementin e aftësimit shkencor të studentëve në praktikën e tyre në vendin eku ata veprojnë. E tëra kjo bëhet

Treguesi i Performancës	Çfarë mat	KPI / Indikator Kryesor	Objektivi vjetor	Metoda e përlllogaritjes
Raporti i aplikuesve për çdo program studimi	Numri i aplikuesve vs numri i pranimeve	Përqindja e pranimeve nga aplikuesit	$\geq 80\%$ e aplikuesve të pranohen sipas kapacitetit	Numri i studentëve të pranuar / Numri i aplikuesve $\times 100$
Performanca akademike e studentëve	Nota mesatare e akumuluar e studentëve	Nota mesatare	$\geq 8/10$	Shuma e notave mesatare të studentëve / Numri total i studentëve
Braktisja e studimeve	Përqindja e studentëve që braktisin studimet para përfundimit	Përqindja e braktisjes	$\leq 10\%$	Numri i studentëve që braktisin / Numri total i studentëve $\times 100$
Mobiliteti i studentëve	Pjesëmarrja në programe vendore dhe ndërkombëtare	Përqindja e studentëve të përfshirë në mobilitet	$\geq 15\%$ e studentëve	Numri i studentëve në mobilitet / Numri total i studentëve $\times 100$
Të diplomuar	Numri i studentëve që përfundojnë programin bachelor	Përqindja e studentëve të diplomuar	$\geq 90\%$ e regjistrimeve përfundojnë	Numri i diplomuar / Numri i studentëve të regjistruar $\times 100$
Norma mësimore e profesorëve	Numri ekuivalent i studentëve për profesor në ngarkesë të plotë	Studentë/profesor	≤ 30 studentë për profesor	Numri total i studentëve / Numri i profesorëve
Raporti teori-praktikë	Lidhshmëria mes teorisë dhe praktikës në lëndë	Përqindja teori/praktikë	Teoria 40% – Praktika 60%	Analizë e programit studimor dhe përputhshmërisë së përmbajtjes

në mënyrë që rezultatet e tyre të jenë të matshme dhe të prekshme dhe jetësohen në përmirësimin e sigurisë publike në vend dhe rajon.

Publikimet shkencore-treguesi i performancës që ju referohet publikimeve shkencore shërben si matës i numrit të publikimeve shkencore të publikuara nëpër revista shkencore apo publikimi i librave apo monografive në vit për stafin akademik.

Konferencat shkencore - ky tregues e mat përqindjen e pjesëmarrjes nëpër konferenca internacionale të stafit akademik krahasuar me numrin e përgjithshëm të stafit akademik në AKSP/FSP. Ky tregues e mat përqindjen e pjesëmarrjes nëpër konferenca internacionale të stafit akademik të drejtimeve për tri vitet e fundit. Gjithashtu, përmes këtij treguesi të performancës paraqitet numri i konferencave shkencore dhe simpoziumeve të organizuara nga AKSP për tri vitet e fundit.

Projektet hulumtuese - ky tregues mat numrit total të projekteve hulumtuese të financuara nga buxheti vjetor (i brendshëm) i AKSP. Ky tregues mat numrin total të projekteve hulumtuese të financuara nga ISP dhe PN;

Projektet e bashkëpunimit -numri i takimeve me ISP vendore dhe ndërkombëtare si dhe Partneret ndërkombëtar brenda vitit. Numri i ndryshimeve të ofruara në programe si pasojë e rekomandimit të ISP-ve dhe PN.

Plani i veprimit-hulumtimi shkencor

Fusha	Përshkrimi	Treguesi i Performancës	Matësi	Periudha e raportimit
Publikime shkencore	Punime, artikuj, monografi, libra nga stafi akademik	Numri i publikimeve shkencore në revista, libra, monografi	Numri i publikimeve të pranuar/botuara në vit për stafin akademik	Vjetore
Konferencat shkencore	Pjesëmarrja e stafit në konferenca dhe organizimi i tyre nga AKSP	Përqindja e pjesëmarrjes së stafit në konferenca ndërkombëtare Numri i konferencave/simpoziumeve të organizuara	Numri i pjesëmarrësve / Numri i stafit total Numri i konferencave dhe simpoziumeve të organizuara	3-vjeçare dhe vjetore
Projektet hulumtuese	Projekte të financuara nga AKSP ose burime të tjera të brendshme	Numri total i projekteve hulumtuese të financuara	Numri i projekteve të miratuara dhe të financuara në vit	Vjetore
Projektet e bashkëpunimit	Takime dhe partneritete me ISP dhe partnerë ndërkombëtarë, ndikimi në programe studimi	Numri i takimeve me ISP/partnerë Numri i ndryshimeve në programe si rezultat i rekomandimeve	Numri i takimeve të zhvilluara Numri i ndryshimeve të implementuara në programet studimore	Vjetore

Bashkëpunimi

Bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar është i domosdoshëm për studentët dhe stafin tonë akademik. Mobiliteti semestral apo vjetor i pajisë studentët tanë me njohuri të reja edukative dhe kulturore, u mëson metoda të reja të punës si dhe u jep mundësi shkëmbimit të përvojave mes tyre.

Mënyra formale e aktiviteteve ndërkombëtare të AKSP/FSP është arritja e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të studentëve me institucione hulumtuese prestigjioze. Aktivitet tjetër shumë i rëndësishëm është bashkëpunimi i departamenteve me homologët e tyre në institucione tjera akademike dhe hulumtuese përmes hulumtimeve të përbashkëta dhe shkëmbimit të vizitave.

Tjetër aktivitet i rëndësishëm është kontributi i njësisë akademike nëpër shoqëri shkencore ndërkombëtare përmes stafit të tyre, aktivitet ky që e promovon pozitën e FSP-së e sidomos asaj të komunitetit shkencor të fushës së sigurisë publike.

Aktivitetet zyrtare ndërkombëtare - përmes këtij treguesi të performancës ne paraqesim numrin e marrëveshjeve tëndryshme të bashkëpunimit me institucione të ndryshme. Përmes këtij treguesi të performancës ne paraqesim numrin e marrëveshjeve tëndryshme të bashkëpunimit me institucione të ndryshme si departamente. Numrin e organizatave/institucioneve ndërkombëtare në të cilët është i anëtarësuar AKSP/FSP.

Bashkëpunimet e përgjithshme shkencore - ky tregues përfshin të dhënat brenda vitit rreth aktiviteteve kryesore në të cilat janë të angazhuar personeli akademik sipas klasifikimit më poshtë.

Plani i veprimit-bashkëpunimi

Fusha	Përshkrimi	Treguesi i Performancës	Matësi	Periodha e raportimit
Aktivitetet zyrtare ndërkombëtare	Marrëveshje të bashkëpunimit, shkëmbime dhe anëtarësime në organizata ndërkombëtare	Numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit Numri i institucioneve/organizatave ku është anëtar AKSP/FSP	Numri i marrëveshjeve të nënshkruara Numri i anëtarësimeve në organizata ndërkombëtare	Vjetore
Mobiliteti i studentëve dhe stafit	Shkëmbime semestrale/vjetore, vizita studimore dhe programe mobiliteti	Numri i studentëve dhe stafit të përfshirë në mobilitet	Numri i studentëve dhe stafit që kanë realizuar mobilitet (hyrës/dalës) në vit	Vjetore
Bashkëpunimi i departamenteve	Projekte të përbashkëta kërkimore, vizita dhe aktivitete me homologët ndërkombëtarë	Numri i projekteve dhe aktiviteteve të përbashkëta Numri i vizitave shkencore	Numri i projekteve të nisura dhe të përfunduara Numri i vizitave të realizuara	Vjetore
Kontributi në shoqëri shkencore	Pjesëmarrja e stafit akademik në shoqëri dhe rrjete shkencore ndërkombëtare	Numri i stafit të angazhuar në shoqëri shkencore Numri i aktiviteteve shkencore	Numri i anëtarësimeve dhe pjesëmarrjeve aktive në shoqëri shkencore ndërkombëtare	Vjetore
Bashkëpunime të përgjithshme shkencore	Angazhimi i personelit akademik në aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare	Numri i aktiviteteve shkencore ku mori pjesë personeli Lloji i aktiviteteve të zhvilluara	Numri total i aktiviteteve shkencore sipas klasifikimit (konferenca, seminare, trajnime, projekte)	Vjetore

Kapacitetet infrastrukturore dhe financiare

Adaptimi i hapësirave të AKSP-FSP me kërkesat e studentëve dhe mundësitë e rritjes së kapaciteteve të infrastrukturës janë parametra për rritje edhe të numrit të pranimit të studentëve dhe shtimit të profileve të reja universitare. Kjo përfshin një sistem efikas të menaxhimit, disponimin e burimeve të duhura qoftë njerëzore apo materiale në mënyrë që të përmirësojë vazhdimisht procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënijes

Kënaqshmëria e stafit - ky tregues ka të bëjë me matjen e nivelit të kënaqshmërisë së stafit sa i përket shërbimeve dhe çështjeve të ndryshme për të cilat janë hulumtuar përmes pyetësorit mbi nivlejn e kënaqshmërisë së personelit në AKSP;

Kënaqshmëria e studentëve - ky tregues e mat nivelin e kënaqshmërisë së studentëve për shërbimet që janë përfshirë në pyetësorë rreth mësimdhënies dhe mësim nxënies, poashtu, edhe për shërbimet e ofruara administrative/teknike.

Aftësitë dhe kualifikimi i të diplomuarve - ky tregues na tregon se sa ju kanë ndihmuar studimet në tonë studentëve për tu adaptuar me kërkesat e reja në fushën e sigurisë publike. Ky tregues na tregon se sa ju kanë ndihmuar studimet në Fakultetin tonë të sigurisë publike të gjithë studentëve për tu adaptuar dhe zgjeruar njohuritë si ato teorike po ashtu edhe praktike në fushën e sigurisë publike. Ky tregues po ashtu na tregon avancimet e studentëve tanë në karrierën e tyre profesionale në ISP respektive;

Biblioteka - përmes këtij treguesi ne e paraqesim numrin e titujve të librave në bibliotekë në raport me numrin e studentëve si dhe shkallën e qasjes në bibliotekë. Përmes këtij treguesi neve kemi modifikuar qasjen dhe kemi zgjeruar mundësinë e pafundme të materialeve mësimore përmes bashkëpunimeve me e-biblioteka (me mbi 700 mijë tituj) vendore dhe ato ndërkombëtare të partnerëve tanë të fushës së sigurisë;

Plani i veprimet-kapacitetet

Fusha / Parametri	Përshkrimi	Treguesi i Performancës	Matësi	Periudha e raportimit
Adaptimi i hapësirave dhe kapaciteteve	Përmirësimi i infrastrukturës, hapësirave mësimore dhe profileve të reja universitare	Numri i hapësirave të përshtatura Numri i profileve të reja të ofruara	Raporti i infrastrukturës në dispozicion për student Numri i programeve të akredituara të reja	Vjetore
Kënaqshmëria e stafit	Vlerësimi i kënaqshmërisë së stafit mbi shërbimet administrative, akademike dhe teknike	Përqindja e stafit të kënaqur sipas pyetësorëve	Rezultatet nga pyetësorët e brendshëm mbi kënaqshmërinë e stafit	Vjetore
Kënaqshmëria e studentëve	Vlerësimi i kënaqshmërisë së studentëve mbi mësimdhënien, mësimnxënien dhe shërbimet administrative	Përqindja e studentëve të kënaqur sipas pyetësorëve	Rezultatet nga pyetësorët e studentëve mbi procesin mësimor dhe shërbimet e ofruara	Vjetore
Aftësitë dhe kualifikimi i të diplomuarve	Përgatitja e studentëve për tregun e punës dhe përshtatja me kërkesat e sektorit të sigurisë publike	Përqindja e të diplomuarve të punësuar Avancimet në karrierë në ISP respektive	Numri i të diplomuarve të punësuar brenda 1–2 viteve Numri i avancimeve në pozita të reja	Dy vite / Vjetore
Biblioteka dhe e-biblioteka	Burimet akademike për studentë dhe staf, përfshirë bibliotekën fizike dhe e-bibliotekat ndërkombëtare	Numri i titujve në bibliotekë Shkalla e qasjes në e-biblioteka	Raporti tituj/student Numri i përdorimeve në e-biblioteka Numri i partneriteteve të reja	Vjetore

Infrastruktura e Akademisë

Infrastruktura fizike - AKSP-ja për zhvillimin sa më të mirë të programit studimor dhe realizimin e misionit të saj institucional posedon, hapësira, salla, kabinete dhe amfiteatro si vijon:

Hapësira	Numër	Sipërfaqja në m2
Salla e mësimi	20	1522.63
Laboratorët	2	140
Kabinete	10	150
Amfiteatrot	1	850

AKSP-ja përveç hapësirave të cekura në tabelën 9.1 posedon edhe objekte tjera përcjellëse si vijon:

- Ndërtesa kryesore, me sipërfaqe prej 4953.07 m2.
- Konvikti I (i dedikuar për akomodim të studentëve) me sipërfaqe prej 2706.35 m2
- Konvikti II (i dedikuar për akomodim të femrave, instruktorëve, me sipërfaqe prej 1293.07 m2
- Konvikti III (i dedikuar për (VIP) – PRV) me sipërfaqe prej 3803 m2 – Ndërtesa 4
- Palestra sportive me dy salla, me sipërfaqe prej 1222.68 m2
- Mensa / objekti për ngrënie, me sipërfaqe prej 548.75 m2
- Ambulanca, me sipërfaqe prej 131.8 m2
- Logjistika, me sipërfaqe prej 1111 m2
- Ngrohësja me sipërfaqe prej 168.16 m2
- Arkiva, me sipërfaqe prej 78.84 m2
- Ndërtesa përballë gjeneratorëve, me sipërfaqe prej 684.85 m2
- Qendra mësimore Steve Bennett, me sipërfaqe prej 1753.39 m2
- Depoja, me sipërfaqe prej 1418.87 m2
- Ndërtesa e kopshtarisë, me sipërfaqe prej 29.50m2
- Ndërtesa për pajisje të kopshtarisë, me sipërfaqe prej 29.30m2
- Ndërtesa Administrative, me sipërfaqe prej 621.2 m2
- Ndërtesa e poligonit të mbyllur, për trajnim me armë të shkurtra me sipërfaqe prej 400 m2
- Ndërtesa e Sigurimit, me sipërfaqe prej 108.7 m2
- Stacioni i pompave, me sipërfaqe prej 20 m2
- Lavanderia, me sipërfaqe prej 288.09 m2
- Fakulteti i Sigurisë Publike 7000 m²

Infrastruktura e TI-së - përveç pajisjeve fizike dhe atyre elektronike AKSP-ja aplikon edhe formatin online të mësimiit përmes platformës “Moodle”.

Pajisjet	Numër
Smart TV 89 inch <i>(për ligjërim interaktiv)</i>	20
Smart boards	10
Projektorë	40
Mjete të konkretizimit	20 tabletë të mençur, flip charts dhe tabela të bardha.
Mjetet laboratorike	Mjete për laborator bazë forenzikës
Internet	Në tërë kampusin e AKSP
WI FI	Në tërë kampusin e AKSP
Numri i kompjuterëve	300
Numri i kompjuterëve për studentët	25
Numri i kompjuterëve për administratën	100% mbulim

Përmes këtij treguesi të performancës ne paraqesim infrastrukturën fizike dhe atë te projekteve kapitale te cilat kanë një ndikim dhe ndryshim esencial në kushtet që ofrohen për aplikimin e programit studimor; në kuadër të projekteve dhe planifikimeve financiare ky tregues është një indikator që kemi ngritje të performancës vjetore në infrastrukturës, dhe mbështetje financiare. Përmes këtij treguesi ne e paraqesim numrin e kompjuterëve për student, gjithashtu, numrin e softuerëve në shërbim të personelit akademik dhe studentëve. Numri i kompjuterëve për staf akademik dhe pajisjeve tjera përcjellëse të fushës së teknologjisë informative. Numri i softuerëve në shërbim të personelit akademik dhe studentëve, përfshirë edhe platformën e mësimiit online “Moodle” dhe sistemi SMU të arsimit të lartë.

Infrastruktura logjistike - për shfrytëzimin e hapësirave për trajnime / ligjërata/ seminare, janë në dispozicion gjithsej 27 klasë: 21 klasë të pajisura me mjete të nevojshme; smart tv per ligjërim dhe table smartboard dhe projektorë. 6 klasë të tipit kontejner, shfrytëzohen vetëm në rast të mungesës së hapësirave të tjera. Po ashtu edhe ndërtesa e fakultetit prej 7000m2 në dispozicion. Kapaciteti maksimal i këtyre hapësirave tejkalon **1000 persona në baza ditore**. Ky tregues e mat përshtatshmërinë dhe cilësinë e infrastrukturës logjistike në funksion të sigurimit të cilësisë me hapësira adekuate për të gjitha aktivitetet e parapara për implementimin e programit studimor;

Burimet njerëzore - AKSP posedon një strukturë tashmë të dëshmuar në aspektin përmbajtjesor qoftë atij akademik, menaxherial dhe të stafit profesional, administrative-teknik mbështetës. Ky tregues e mat përmbushjen e burimeve njerëzore të duhura dhe në dispozicion për proceset arsimore.

Totali i stafit te AKSP	Përbërja strukturore e stafit të Akademisë																
	Ngritja profesionale				Përbërja etnike									Gjinore		Aftësi te kufizuar	
	Fakultet	Shkollim i lartë	Shkollim i mesëm	shkollim fillor	Shqiptar	Serbë	Boshnjak	Turk	Goran	Ashkali	Egjiptian	Romë	Etni tjera	Mashkull	Femër	Mashkull	Femër
126	71	1	64	0	121	3	0	2	0	0	0	0	0	81	45	2	0

Burimet financiare - AKSP-ja njëherësh siguron që shpenzimet financiare janë bërë në përputhje me rregullat dhe procedurat buxhetore përfshirë dhe në mënyrë të veçante aplikimin e programit studimor. Ky tregues performanca tregon shumën e buxhetit të AKSP të planifikuar për tri vitet.

Llojet e Shpenzimeve	2026	2027	2028	2029	2030	TOTAL (€)
Stafi akademik	149,474	149,474	149,474	149,474	149,474	747,370
Stafi administrativ	29,430	29,430	29,430	29,430	29,430	147,150
Pajisje dhe materiale mësimore	10,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00	50,000.00
Zhvillimi profesional	5,000.00	5,000.00	5,000.00	5,000.00	5,000.00	25,000.00
Aktivitetet studentore	4,000.00	4,000.00	4,000.00	4,000.00	4,000.00	20,000.00
Promovimi i programit	2,000.00	2,000.00	2,000.00	2,000.00	2,000.00	10,000.00
Operime & mirëmbajtje SMU	10,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00	50,000.00
(Sistemi i Menaxhimit Universitar)	12,000.00	12,000.00	12,000.00	12,000.00	12,000.00	60,000.00
Akreditimi						
Totali i Shpenzimeve	221,904.00	221,904.00	221,904.00	221,904.00	221,904.00	1,109,520

Shërbimet mbështetëse - AKSP ofron një mori shërbimesh, si biblioteka, sigurimi i kampusit, pastaj shërbimet mjekësore, gjuhësore dhe atyre të përbashkëta.

- Përmes këtij treguesi të performancës ne paraqesim shërbimet mbështetëse të cilat ofrohen edhe për studentët e FSP, nga ato mjekësore, gjuhësore dhe atyre të përbashkëta në të cilat përshtatshmëria dhe larmia e tyre lehtësojnë jetën studentore në AKSP/FSP.